

VENDIM
Nr. 104, datë 1.3.2023

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË SHTETIT DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT TË OBJEKTIT
“*ATRIUM CENTER THUMANA*”, NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË,
BASHKIA KRUIJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të shtetit dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të objektit “*Atrium Center* Thumana”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, sipas tabelës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTIN “*ATRIUM CENTER THUMANA*”
(TABELA E INVENTARIT)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m ²)	Vlera e projekt-idesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqërjesit	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
1	Durrës	Krujë	Thumanë	Objekt shumëfunktional	“ <i>Atrium Center</i> ” Thumana	Ndërtim	Buxhet GovA	2,071.0	-	220,079,942.00	1,695,073.00	70,123.00	221,845,138.00
TOTAL								2,071.0	-	220,079,942.0	1,695,073.0	70,123.0	221,845,138.0